



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 27 datë 24.04.2026

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR RIKONSTRUKSION PA NDRYSHIM
FUNKSIONI PËR OBJEKTIN: “RIKONSTRUKSION I MAUZOLEUMIT TË
DËSHMORËVE”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN “ALEKSANDËR GOGA”,
BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues Bashkisë Durrës, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për rikonstrukcion pa ndryshim funksioni për objektin: “Rikonstrukcion i Mauzoleumit të Dëshmorëve”, me vendndodhje në Rugën “Aleksandër Goga”, Bashkia Durrës, me subjekt zhvillues Bashkinë Durrës
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuarit vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënskruar më datë 29/07 2026